

| Emri i Lëndës : Private International Law |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
|-------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                                      | Tipi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| LAW 422                                   | B                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Pranverë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 3.00                | 0.00                | 1.00           | 3.50    | 6.00 |
|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Ada Güven, PhD                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Master                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Lënda “E Drejtë Ndërkombëtare Private” u jep studentëve njohuri lidhur me raste specifike kur marrëdhëniet juridiko-civile karakterizohen nga ekzistenca e një elementi të huaj, cka ndikon në mënyrën sesi do trajtohet çështja nga gjykatat. Gjatë këtij kursi, studentët do jenë të aftë të identifikojnë dhe t'u japin zgjidhje rasteve kur kemi konflikte mes ligjeve të shteteve të ndryshme duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për të drejtën ndërkombëtare private si dhe në burime të tjera. Gjithashtu, do të trajtohen edhe bazat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe të marrëveshjeve të arbitrazhit, me anë të qasjes praktike duke evidentuar avantazhet dhe disavantazhet e arbitrazhit dhe çështje të tjera të lidhura me to. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë të aftë të njohin të Drejtën Ndërkombëtare Private në përgjithësi, çështjet e lidhura me juridiksionin e gjykatës shiptare, ligjin e zbatueshëm, zgjedhjen e ligjit për çështje të ndryshme lidhur me familjen, pronësinë, detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore dhe arbitrazhin.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 1. Normat e konfliktit 2. Elementi i huaj 3. Ligji i zbatueshëm 4. Klauzola e rendit publik 5. Arbitrazhi ndërkombëtar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| Java                                      | Tema                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| 1                                         | Hyrje e përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare private/ Vështrim historik në të drejtën ndërkombëtare private Njohuri të përgjithshme mbi të drejtën ndërkombëtare private duke shpjeguar disa nga konceptet më të rëndësishme të lëndës si dhe duke analizuar zhvillimin historik të saj dhe fushën e veprimit. Gjithashtu, shqyrtohet raporti që ka e drejta ndërkombëtare private me degët e tjera të së drejtës si e drejta ndërkombëtare publike, e drejta kushtetuese dhe e drejta civile përfshirë e drejta familjare, e drejta e detyrimeve, e drejta tregtare etj.. (Fq. 13-40) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| 2                                         | Burimet e së drejtës ndërkombëtare private Shpjegimi i burimeve të së drejtës ndërkombëtare private duke përfshirë burimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Tema trajton mënyrën sesi burimet ndërkombëtare bëhen pjesë e sistemit ligjor të brendshëm duke patur parasysh procedurën e parashikuar në Kushtetutë. (Fq. 41-58)                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| 3                                         | Marrëdhëniet juridike ndërkombëtare private Kjo temë trajton marrëdhënien juridike ndërkombëtare private duke përcaktuar se cilat janë subjektet e kësaj marrëdhënie dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre. Leksioni ndalet vecanërisht tek shteti si një subjekt i vecantë i marrëdhënies juridike. Gjithashtu, analizohen personat fizikë në cilësinë e shtetasve shqiptarë dhe të huaj dhe personat juridike duke përmendur pozitën juridike të tyre. (Fq. 59-94)                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| 4                                         | Normat e konfliktit, ndërtimi dhe vecoritë e saj Kjo temë jep kuptimin e normës së konfliktit, funksionin dhe karakteristikat e saj. Gjithashtu, ky leksion analizon elementët përbërës të normës së konfliktit që janë tregimi i fakteve dhe kriteri i lidhjes. (Fq. 95-118)                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |
| 5                                         | Aplikimi dhe efektet e normave të konfliktit Tema përqëndrohet tek aplikimi i normave të konfliktit duke patur parasysh kriteret e lidhjes që ekzistojnë në marrëdhënien juridike me elementë të huaj. Ndër objektivat e kësaj jave janë edhe dhënia e kuptimeve dhe pasqyrimi me shembuj i nocioneve si klauzola e rendit publik, parimi i reciprocitetit dhe mënyrat e referimit tek ligji i huaj. (Fq. 119-136)                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                     |                     |                |         |      |

|           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
